



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 20.09.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.09.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “**Komtel Projecy Engieering sh.p.k**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “**Furnizimi dhe mirëmbajtja me smart city kamera publike,shtyllat multifunkionale dhe paisjet tjera faza IV-rë, me Nr. të Prok: 632-21-3045-1-1-1, Nr. Brendshëm : 632-21-056-111.**
, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik “**Komtel Projecy Engieering sh.p.k.**, të dt.13.09.2021, lidhur me aktivitetin e prokurimit **Furnizimi dhe mirëmbajtja me smart city kamera publike,shtyllat multifunkionale dhe paisjet tjera faza IV-rë, me Nr. të Prok: 632-21-3045-1-1-1, Nr. Brendshëm : 632-21-056-111.**, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**, te AK –së, të datës 08.09.2021, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë 08.09.2021;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

Ar sy e t i m

Me dt.13.09.2021 Operatori Ekonomik “Komtel Projecy Engieering sh.p.k., kaparashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e Furnizimi dhe mirëmbajtja me smart city kamera publike, shtyllat multifunkionale dhe paisjet tjera faza IV-rë, me Nr. të Prok: 632-21-3045-1-1-1, Nr. Brendshëm : 632-21-056-111.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 20.09.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Fillimisht ky aktivitet i prokurimit nuk është udhëhequr konform nenit 1. Qëllimi të LPP-së: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, meqë po propozuar për shpërblim me kontratë një OE i cili ka dorëzuar një ofertë për 44,780.00 € më të lartë se sa oferta jonë, duke shkelur kështu edhe nenin Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës i cili në DT ka qenë çmimi më i ulët.

Kriteri i dhënies ka qenë OE i përgjegjshëm me çmimin me të lire.

Pastaj një vlerësim i tillë tërësisht favorizues ndaj markës “ AVIGILON” dhe diskriminues ndaj seciles marke/brend tjetër në botë. Prandaj si e tillë shkel Nenin 7 Barazia në Trajtim/JoDiskriminimi paragrafi 2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik. Dhe si përfundim ka shkelur Nenin 28. Specifikimet teknike Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

OE ka mundur të kerkoje sqarime shtese edhe para hapjes se ofertave ne kohen e sqarimeve.

Arsyeja 2. Kontratat dhe Referencat e Komtel: Ne listën e kontratave nuk janë paraqitur disa referenca dhe një referencës i mungon nënshkrimi dhe vula.

Sqarim – Bazuar ne RRUOPP neni 39. Sqarimi i Tenderëve

Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave te prezantuara	Mund te kërkohen informata sqaruese	69
---	-------------------------------------	----

Një kërkesë e tillë për informata sqaruese nuk është bërë nga AK, prandaj përveq që ndihemi të diskriminuar nga vlerësimi i AK neni 7 i LPP, ky vlerësim shkel nenin 39 të RRUOPP-së.

RRUOPP thotë që AK mund të kërkojnë informata sqaruese andaj AK nuk ka kërkuar sqarim shtese kur per nje pike tjetër te caktuar te dosjes se tenderit gjegjësisht specifikave teknike oferta e OE është eliminuar.

Lidhur me referencat dhe kontratat e “KUJTESA Net Sh.p.k” dhe “PANAMIC ICT L.L.C” sipas nenit 39. Sqarimi i Tenderëve të RRUOPP-së.

Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave te prezantuara	Mund te kërkohen informata sqaruese	69
Lista e kontratave te realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë (referenca/certifikata e pranimit/kontrata)	Mund te kërkohen informata sqaruese	69

RRUOPP thotë qe AK mund te kërkohen informata sqaruese andaj AK nuk ka kërkuar sqarim shtese kur per nje pike tjetër te caktuar te dosjes se tenderit gjegjësisht specifikave teknike oferta e OE eshte eliminuar.

Mirëpo pavarësisht kësaj nëse si dokumente nuk kanë përmbajtur informata të kërkuara ju si AK është dashur të kërkonte info shtesë konform nenit 39 të RRUOPP-së.

CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund te vendos	Mund te kërkohen informata sqaruese	69
---	-------------------------------------	----

RRUOPP thotë qe AK mund te kërkohen informata sqaruese andaj AK nuk ka kërkuar sqarim shtese kur per nje pike tjetër te caktuar te dosjes se tenderit gjegjësisht specifikave teknike oferta e OE eshte eliminuar.

Sa i përket pretendimit qe eshte bere shkelje e Nenit 7, Paragrafi 2 :

Shpjegim: AK ka paraqitur specifikat e kerkuara per sistemin e kamerave te cilat jane paraqitur ne Dosjen e Tenderit. Specifikat e tilla jane percaktuar duke pasur parasysh pervojen e Komunes se Gjakoves me projektet e realizuara ne te kaluaren, pa e percaktuar ne asnje moment prodhuesin. Specifikat e kerkuara plotesojne kerkesat e AK dhe secili ofertues ka mundur te ofroje sistemin e kamerave te cilat i plotesojne keto specifika teknike pa marre parasysh prodhuesin.

Sa i perket pretendimit tuaj se vetem kamerat e prodhuesit Avigilon plotesojne keto kerkesa, ju si OE keni mundur te ofertoni me kete prodhues apo te gjeni prodhues tjetër i cili ploteson te gjitha specifikat e kerkuara.

Deklarimi juaj qe vetem kamerat Avigilon ploteson kushtet e kerkuara, bie ne kundërshtim me arsyetimin tuaj se Specifikat teknike te prodhuesit Pelko plotesojne specifikat e kerkuara (ne te cilat thirreni dhe te cilat i ofroni tani si dokumente shtese dhe te cilat nuk jane paraqitur ne oferten tuaj te dorezuar).

Sqarimet per: Arsyjeja 1

Kamerat

Oferta juaj ne lidhje me Softuerin perkrahe kamerat me rezolucion deri ne 12 Mpx – ndersa ne Dosjen e Tenderit eshte kerkuar qe te perkrahe kamerat deri ne 40 Mpx

Oferta juaj ne lidhje me Softuerin perkrahe video regjistrimet ne formatin MJPEG, MPEG-4, H.264, and H.265, ndersa ne Dosjen e Tenderit eshte kerkuar te perkrahe video regjistrimet ne formatin H.264, H.265 and JPEG2000.

Sa i perket kerkesave te Softuerit ne lidhje me aftesite analitike, ne oferten tuaj mungojne keto specifika:

- Detection of abnormal behaviour/motion in the scene based on speed and location of movement
- Detection of Objects – All vehicle sub classes (cars, trucks, buses, bicycles and motorbikes)
- Detect if the people are not wearing face masks
- Detect violation in social distancing (measuring distance between classified objects (persons))
- Count the occupancy to prevent more people at restricted area than maximum allowed

Pergjegjet ne Arsyet tuaja te cilat i keni paraqitur ne ankesen tuaj:

1. Eshte kerkuar ne Dosjen e Tenderit: **Motion Detection: Pixel (motion zone defined per pixel), abnormal behavior/motion in the scene and classified objects (min. people, cars, trucks, buses, bicycles and motorbikes)**

Shpjegim: Ne oferten tuaj nuk e keni plotesuar kete kerkese, qe Kamerat te mund te identifikojne: Njerezit, Vetura, Autobuset, Kamionet, Bicikletat dhe Motoriukletat. Edhe ne dokumentin te cilit i referoheni ne ankesen tuaj nuk plotesohet kjo kerkese e Dosjes se Tenderit,

2. Eshte kerkuar ne Dosjen e Tenderit: **Privacy Zones: min. 20 zones (GDPR compliant)**

Shpjegim: Ne oferten tuaj nuk e keni plotesuar kete kerkese. Ne dokumentin te cilit i referoheni per prodhuesin Pelco, ne faqen 6 shkruan: “3. Privacy zone definition: up to 16 configurable windows of blanking”, ndersa eshte kerkuar ne Dosjen e Tenderit min 20 zona.

3. Eshte kerkuar ne Dosjen e Tenderit:

Intelligent video analytics:

- **Auto-configuration and auto-calibration (self-learning analytics)**
- **Classification of objects: min. people, cars, trucks, buses, bicycles and motorbikes**
- **Objects detection in area of interest**
- **Crossing line object detection**
- **Detection when object is not present in the area**
- **Detection when object stops in the area**
- **Detection when objects violate direction**
- **Object loitering detection**

- **Detection of abnormal behavior/motion in the scene based on speed and location of movement**
- **Detect if the people are not wearing face masks.**
- **Detect violation in social distancing.**
- **Count the occupancy to prevent more people at restricted area than maximum allowed.**
- **Tamper Detection (scene unexpectedly covered/masked)**

Shpjegim: Ju i referoheni dokumentit qe keni derguar ne ankesen tuaj per kamerat Pelco, ku ne faqen 6 shkruan: “12. Capable of advanced analytics” dhe konsideroni qe kjo fjali mbulon cfaredo specifike analatike qe ekziston.

Ky eshte term i gjere dhe askund nuk mund te gjendet qe plotesohen te gjitha specifikat e kerkuara dhe oferta juaj ne menyre specifike nuk ploteson keto kerkesa:

- Detection of abnormal behaviour/motion in the scene based on speed and location of movement
- Classification of objects: min. people, cars, trucks, buses, bicycles and motorbikes
- Detect if the people are not wearing face masks
- Detect violation in social distancing
- Count the occupancy to prevent more people at restricted area than maximum allowed

4. **Eshte kerkuar ne Dosjen e Tenderit:** USB port: min. USB 2.0 for connecting WiFi adapter

Shpjegim: Kamerat te cilat i keni ofruar ne oferten tuaj, nuk kane port USB

1. Eshte kerkuar ne Dosjen e tenderit: **Certifications/Directives: min. CE, IEC 62471, IP67 Weather Rating and IK10 Impact Rating**

Shpjegim: Ne dokumentin te cilit i referoheni, nuk kemi gjetur qe oferta juaj ploteson standardin e kerkuar IEC62471.

Serveri:

1. Eshte kerkuar ne Dosjen e Tenderit: **Recording Rate: min. 1500Mbps.**

Shpjegim: Ne oferten tuaj, bazuar ne Datasheet qe keni dorezu eshte ofruar: “Up to 1000 Mbps”.

2. Eshte kerkuar ne Dosjen e Tenderit: **Live and Playback Rate: min. 600Mbps for simultaneous image review and live monitoring.**

Shpjegim: Ne oferten tuaj, bazuar ne Datasheet qe keni dorezu eshte ofruar: “Up to 175 Mbps”.

3. Eshte kerkuar ne Dosjen e Tenderit: **Embedded module for deep-learning video analytics supporting min. 150 cameras**

Shpjegim: Ne oferten tuaj, bazuar ne Datasheet qe keni dorezuar, nuk perkrahet kjo specifike.

4. Eshte kerkuar ne Dosjen e Tenderit: “**Min. 6 x 1Gbps RJ-45 ports (1000Base-T)**”

Shpjegim: Ne datasheet te Serverit qe keni ofruar, nuk plotesohet kjo kerkese. Shpjegimi juaj qe kjo kerkese mund te plotesohet duhet instaluar nje karte shtese nuk eshte konform kerkeses ne dosjen e tenderit.

Sqarimet per: Arsyjeja 4

Shpjegim: Ne Dosjen e Tenderit eshte kerkuar te prezantohet “**Diagrami i lidhies apo migrimit**”.

Ne oferten tuaj keni paraqitur nje skeme te thjeshte, e cila nuk ploteson asnje kusht te nje Skeme profesionale e cila tregon menyren e integritimit dhe te migrimit te sistemit te meparshem te kamerave me sistemin i cili do te ndertohet ne kete faze. Ne kete menyre nuk e keni plotesuar kete kerkese te Dosjes se Tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit


Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës